

VENDIM
Nr. 1217, datë 27.5.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e përbërë nga:

Gjyqtare: Vjola CANAJ

Sot në Vlorë, më datë 27.5.2025, mori në shqyrtim kërkesën civile/tregtare, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Kapaj” sh.p.k. NUIS K67016202A, administrator z. Bedri Kapaj.

OBJEKTI: Fillimi i procedurës së falimentit.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 14, 17, 20, 23 e vijues të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

VERËN:

Gjykata pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëngjitur saj, konstatoi se kërkesa plotëson kushtet formale të parashikuara nga neni 14, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Në zbatim të nenit 17, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, gjykata pas një vështrimi të përgjithshëm të dokumenteve bashkëngjitur kërkesës është në pamundësi për të konstatuar gjendjen e paaftësisë paguese të debitorit. Në kushte të tilla, në zbatim të nenit 19, pika 1, germa “c” dhe neni 23, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, gjykata e falimentimit përpara fillimit të procedurës, të caktojë si masë të përkohshme një administrator të përkohshëm falimentimi, saktësisht z. Luan Muça. Ky i fundit realizoi detyrat e lëna nga gjykata dhe me raportin e depozituar ka arritur në konkluzionin se:

- Minimalisht prej vitit 2018, shoqëria nuk ka gjendje likuiditete për të shlyer detyrimet kundrejt të tretëve;

- Ekziston shkak real për hapjen e procedurës së falimentit, pasi qysh prej vitit 2017 shoqëria nuk ka pasur aftësi paguese për shlyerjen e detyrimeve;

- Në gjendjen aktuale të informacionit konkludohet se pasuria e debitorit mbulon shpenzimet e procedurës së falimentit;

- Nuk është e nevojshme të merren masa për sigurimin e pasurisë;

- Nuk ka mundësi të zhvillohet veprimtaria e debitorit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306–308, të K. Pr. Civile, nenin 29 e vijues të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit, Shoqëria “Kapaj” sh.p.k.

2. Hapjen në orën 14:30, të datës 27.5.2025, të procedurës së falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. NUIS K67016202A me administrator z. Bedri Kapaj, me seli në: lagja “Partizani”, rruga “Ali Demi”, Vlorë.

3. Emërimin si administrator të falimentimit, për shoqërinë “Kapaj” sh.p.k., të z. Luan Muça, i regjistruar në listën e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, me adresë: lagja “Demokracia”, ish-magazinat e N. T. A, I-it, Tepelenë, +355692290763, luanmuca1961@yahoo.com

4. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.

5. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratorin e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorit të falimentimit, z. Luan Muça.

7. Mbledhja e kreditorëve të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. për raportim, të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, të publikohet shkurtimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në Fletoren Zyrtare.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i njoftohet administratorit të falimentimit, z. Luan Muça.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Qendrore, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Kapaj” sh.p.k. t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

19. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Vlorë, sot, më datë 27.5.2025, ora 14:30.

GJYQTARE
Vjola Canaj